

VENDIM
Nr. 122, datë 2.3.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE
“PICAR”, BASHKIA VORË, DHE KAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI
ZBATUESE**

(ndryshuar nga VKM nr. 775, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” e “iii”, 16, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, në masën 139 613 966.96 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 27 922 793 (njëzet e shtatë milionë e nëntëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2/1. Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, edhe në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

3. Kaktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese, për financimin e rindërtimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të shkollës 9-vjeçare “Picar”, Bashkia Vorë, sipas pikave 1, 2 dhe 2.1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama